



Në bazë të nenit 14 të Ligjit mbi tokën ndërtimore (“Gazeta zyrtare e Kosovës” nr. 14/80 dhe 42/86), të nenit 3, par. 1, pika b. të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, të nenit 7 të Rregullores për dhënien e tokës ndërtimore në shfrytëzim të përkohshëm për ndërtimin-vendosjen e objekteve të përkohshme, nr. 01.-01.-2, të datës 03.01.2002, të nenit 19, par. 1, pika b. dhe të nenit 40 të Statutit dhe Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.02.2006 merr

V E N D I M

MBI ÇAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E OBJEKTIT ME KARAKTER TË PËRKOHSHËM PËR NEVOJAT E SHËRBIMIT POLICOR TË KOSOVËS

Neni 1

MIRATOHET Vendimi mbi caktimin e lokacionit për vendosjen e objektit të përkohshëm (konteinerit) për nevojat e Shërbimit Policor të Kosovës.

Lokacioni, nga paragrafi 1 i këtij neni, gjendet në pjesën e ngastrës kadastrale nr. 733, Komuna kadastrale Hajvali, e evidencuar në fletën poseduese nr. 517, pronë e Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Neni 2

Lokacioni, nga neni 1 i këtij Vendimi, i jepet në shfrytëzim të përkohshëm Shërbimit Policor të Kosovës, në kohëzgjatje prej 1 viti, me mundësinë e vazhdimit të kësaj të drejte edhe pas kalimit të këtij afati.

Neni 3

Kushtet urbanistike-teknike dhe lejimin e vendosjes së objektit në lokacionin e caktuar sipas këtij Aktvendimi, i cakton Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës.

Drejtorati i Gjeodezisë dhe i Kadastrit, i Komunës së Prishtinës është përgjegjës për kryerjen e veprimeve procedurale nga përgjegjësia e tij për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës

Neni 5

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është edhe pjesa grafike e situacionit të lokacionit nga neni 1 i këtij Vendimi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.353-87 , më 21.02.2006

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri